



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**  
**PA1 Nr.03-363**  
**24.11.2023**  
**Shkup**

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 98 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 5 dhe pika 14 e Rregullores për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-3348/1 datë 01.09.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4325/5 datë 23.11.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 38-të mbajtur më 23.11.2023, miratoi si vijon:

**Aktvendim**  
**për ndërmarrje të masës – vërejtje publike**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, për shkelje të kryer nga neni 98 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), të mënyrës që në kuadër të shërbimit programor televiziv, transmetuar më 9 gusht 2023, është regjistruar transmetim i reklamave që nuk është i ndarë qartë nga pjesët e tjera të programit, respektivisht është transmetuar pa u shënuar me mjetet optike dhe/ose zëri në fillim dhe në mbarim.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikur në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-3348/1 datë 01.09.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky aktvendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratimin e tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

**A r s y e t I m**

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në bazë të nenit 28 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele është kompetente të kryejë mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës, si dhe të pakove programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të Ligjit në fjalë, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masën – aktvendim për vërejtje publike në pajtim me këtë Ligj, në rastet kur është kryer shkelje e dispozitave të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve përcaktuar me lejet dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 98 paragrafi (1) të LSHMAAV reklamimi dhe teleshoppingu duhet të identifikohen qartë dhe të jenë të ndarë nga pjesët e tjera të programit. Për të mos penguar përdorimin e teknikave të reja të reklamimit, përveç mjeteve optike dhe/ose zëri reklamimi dhe teleshoppingu mund të ndahen nga pjesët e tjera të programit dhe me mjete hapësinore.

Në kuadër të kompetencave të saj Ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 1 shtator 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, transmetuar më 9 gusht 2023, në nivel lokal, nga ku u konstatua

shkelja e nenit 98 paragrafi (1) të LSHMAAV. Përkatësisht në disa raste në ditën e analizës (9 gusht 2023) të shërbimit programor televiziv të SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë është regjistruar transmetimi i reklamave që nuk janë ndarë qartë nga pjesët e tjera të programit, respektivisht është transmetuar pa u shënuar me mjetet optike dhe/ose zëri, në fillim dhe mbarim.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-3348/1 datë 01.09.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, më 06.09.2023, ka dërguar Shkresë ark.nr.10-3348/2 datë 06.09.2023, me të cilën i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-3348/1 datë 01.09.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshilli të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga ana e transmetuesit më 29.09.2023. Në afatin e paraparë, SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 23.11.2023, pasi shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konkludoi që SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, t'i shqiptoi masën – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 98 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 5 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3348/1 datë 01.09.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4325/5 datë 23.11.2023, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 23.11.2023, miratoi Aktvendim me të cilën publikisht paralajmërohet SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë dhe obligohet që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër, u mor vendim si në dispozitiv.

#### **Shtojcë (1):**

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-3348/1 datë 01.09.2023

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuele  
Kryetari i Këshilli,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.